RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN

"PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 27/2018 PËR TRASHËGIMINË KULTURORE DHE MUZETË, TË NDRYSHUAR"

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 27/2018 'Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë', të ndryshuar" synon përmirësimin dhe modernizimin e kuadrit ligjor në fushën e trashëgimisë kulturore, me qëllim forcimin e mekanizmave të mbrojtjes, ruajtjes, administrimit dhe përdorimit të qëndrueshëm të pasurive kulturore, si dhe përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit kombëtar me standardet dhe detyrimet ndërkombëtare dhe ato të Bashkimit Evropian në këtë fushë.

Nëpërmjet ndryshimeve të propozuara synohet forcimi dhe qartësimi i kuadrit institucional në fushën e trashëgimisë kulturore, rregullimi më i detajuar i procedurave të identifikimit, verifikimit, deklarimit dhe regjistrimit të pasurive kulturore materiale dhe jomateriale, si dhe përcaktimi më i qartë i kompetencave të institucioneve përgjegjëse për mbrojtjen, ruajtjen dhe administrimin e tyre.

Projektligji parashikon gjithashtu instrumente të reja për vlerësimin dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, si Vlerësimi i Ndikimit në Trashëgiminë Kulturore (VNT/HIA), studimi i posaçëm dhe harta e vlerave, si dhe rregullon më qartë kushtet dhe procedurat për ndërhyrjet, mirëmbajtjen, restaurimin, përshtatjen funksionale dhe rijetëzimin e pasurive kulturore, duke garantuar ruajtjen e autenticitetit, integritetit dhe vlerave të tyre kulturore.

Njëkohësisht, projektligji forcon mekanizmat e financimit dhe mbështetjes për ruajtjen e trashëgimisë kulturore, duke parashikuar instrumente të posaçme për financimin, bashkëfinancimin dhe mbështetjen e pasurive kulturore, përfshirë ato në pronësi jopublike, si dhe përmirëson kuadrin ligjor për importin, eksportin, qarkullimin dhe rikthimin e pasurive kulturore të larguara në mënyrë të paligjshme.

Në tërësi, ndryshimet e propozuara synojnë rritjen e efektivitetit të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, garantimin e një administrimi më të qartë, më funksional dhe më transparent të saj, si dhe krijimin e kushteve për ruajtjen e vlerave

kulturore.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KESHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TE AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 27/2018 'Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë', të ndryshuar" nuk është i parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave për vitin 2026.

Hartimi i këtij projektligji është diktuar nga nevoja për përmirësimin dhe modernizimin e kuadrit ligjor në fushën e trashëgimisë kulturore, në funksion të forcimit të mekanizmave të mbrojtjes, ruajtjes, administrimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm të pasurive kulturore, si dhe të rritjes së efektivitetit të institucioneve përgjegjëse për administrimin e trashëgimisë kulturore. Ndryshimet e propozuara synojnë gjithashtu përshtatjen e legjislacionit me zhvillimet bashkëkohore në fushën e menaxhimit të trashëgimisë kulturore dhe përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga instrumentet ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë.

Projektligji është në përputhje me objektivat e politikave qeveritare për mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore, zhvillimin e qëndrueshëm dhe integrimin evropian. Nëpërmjet tij synohet krijimi i një kuadri më të plotë normativ për administrimin e pasurive kulturore, forcimi i mekanizmave të kontrollit dhe monitorimit të ndërhyrjeve në pasuritë kulturore, si dhe rritja e transparencës dhe e sigurisë juridike në proceset vendimmarrëse.

Po ashtu, projektligji mbështet angazhimet e Republikës së Shqipërisë në kuadër të procesit të integrimit evropian, duke përfshirë përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit vendas me aktet dhe standardet e Bashkimit Evropian në fushën e importit, eksportit, lëvizjes dhe kthimit të pasurive kulturore, si dhe forcimin e masave për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të paligjshëm të pasurive kulturore.

Projektligji reflekton gjithashtu standardet dhe rekomandimet ndërkombëtare në fushën e trashëgimisë kulturore, duke harmonizuar përkufizimin e muzeut me përkufizimin e përditësuar të Këshillit Ndërkombëtar të Muzeve (ICOM) dhe duke përfshirë për herë të parë në legjislacionin kombëtar Vlerësimin e Ndikimit në Trashëgiminë Kulturore (VNT/HIA), në përputhje me dokumentet udhëzuese dhe kërkesat e UNESCO-s.

Ndryshimet e propozuara janë gjithashtu në përputhje me angazhimet dhe detyrimet që rrjedhin nga konventat ndërkombëtare në fushën e trashëgimisë kulturore, duke synuar forcimin e instrumenteve ligjore për identifikimin, mbrojtjen, ruajtjen, dokumentimin dhe transmetimin e vlerave kulturore tek brezat e ardhshëm. Në këtë kuadër, projektligji parashikon instrumente të reja, si Vlerësimi i Ndikimit në Trashëgiminë Kulturore (HIA), studimi i posaçëm dhe harta e vlerave, si dhe rregullime më të detajuara për ndërhyrjet, përshtatjen funksionale dhe menaxhimin e qëndrueshëm të pasurive kulturore.

Në tërësi, projektligji përbën një ndërhyrje të domosdoshme për konsolidimin e kuadrit ligjor të trashëgimisë kulturore, forcimin e kapaciteteve institucionale dhe garantimin e një niveli më të lartë mbrojtjeje dhe administrimi të pasurive kulturore, në përputhje me prioritetet kombëtare të zhvillimit dhe procesin e integrimit evropian.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Zbatimi i ligjit nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", të ndryshuar, ka evidentuar nevojën për përmirësimin e disa dispozitave që lidhen me mbrojtjen, administrimin dhe menaxhimin e trashëgimisë kulturore, si dhe për qartësimin e procedurave dhe kompetencave të institucioneve përgjegjëse në këtë fushë. Gjithashtu, zhvillimet e viteve të fundit në administrimin e pasurive kulturore, nevoja për përdorimin e instrumenteve bashkëkohore të vlerësimit dhe menaxhimit, si dhe përmbushja e detyrimeve që rrjedhin nga instrumentet ndërkombëtare, kanë bërë të domosdoshëm rishikimin e kuadrit ligjor ekzistues.

Projektligji adreson nevojën për rregullimin më të plotë të procedurave që lidhen me identifikimin, verifikimin, dokumentimin dhe administrimin e pasurive kulturore materiale dhe jomateriale, si dhe përmirëson kuadrin normativ që rregullon ndërhyrjet në pasuritë kulturore, duke krijuar dallim më të qartë ndërmjet mirëmbajtjes së zakonshme, ndërhyrjeve ruajtëse dhe masave urgjente. Në të njëjtën kohë, ai forcon instrumentet ligjore në funksion të mbrojtjes së pasurive kulturore dhe siguron një bazë më të qartë për proceset vendimmarrëse në këtë sektor.

Një aspekt i rëndësishëm i projektligjit lidhet me krijimin e mekanizmave të nevojshëm për vlerësimin e ndikimit të projekteve dhe ndërhyrjeve mbi trashëgiminë kulturore, nëpërmjet parashikimit të instrumenteve si Vlerësimi i

Ndikimit në Trashëgiminë Kulturore (VNT/HIA), studimi i posaçëm dhe harta e vlerave. Këto instrumente synojnë të mbështesin një proces vendimmarrjeje të bazuar në analiza teknike dhe profesionale, duke garantuar mbrojtjen e vlerave kulturore në raport me zhvillimin ekonomik dhe territorial. Përfshirja e VNT/HIA adreson gjithashtu rekomandime të evidentuara gjatë proceseve të monitorimit të pasurive të mbrojtura dhe nevojën për krijimin e mekanizmave të posaçëm për vlerësimin paraprak të ndikimeve të projekteve zhvillimore mbi trashëgiminë kulturore.

Projektligji synon gjithashtu forcimin e mekanizmave të financimit dhe mbështetjes së pronarëve dhe administruesve të pasurive kulturore, si dhe përmirësimin e dispozitave që lidhen me importin, eksportin, qarkullimin dhe kthimin e pasurive kulturore të larguara në mënyrë të paligjshme, në përputhje me standardet dhe praktikat ndërkombëtare në këtë fushë.

Sa i përket interesit kulturor, rishikimi i dispozitave që rregullojnë verifikimin e interesit kulturor synon përmirësimin e efikasitetit të procedurës së identifikimit dhe deklarimit të pasurive kulturore, si dhe adresimin e problematikave të evidentuara gjatë zbatimit të legjislacionit në fuqi. Praktika e deritanishme ka evidentuar raste të vonesave në përfundimin e procedurave të verifikimit, mungesë të një përcaktimi të qartë të përgjegjësive institucionale dhe vështirësi në koordinimin ndërmjet institucioneve të përfshira në proces.

Në këtë kuadër, projektligji përcakton në mënyrë më të qartë institucionet kompetente për verifikimin e interesit kulturor sipas kategorive të trashëgimisë kulturore, rregullon përmbajtjen e raportit të vlerësimit, përcakton afate procedurale për përfundimin e procesit të verifikimit dhe krijon mekanizma për vendosjen e masave mbrojtëse paraprake në rastet kur ekziston rreziku i dëmtimit, tjetërsimit ose humbjes së pasurisë.

Ndryshimet synojnë të përshpejtojnë procesin e shqyrtimit dhe vendimmarrjes, të përmirësojnë cilësinë dhe standardizimin e produktit të verifikimit, të rrisin sigurinë juridike për subjektet e interesuara dhe të garantojnë një mbrojtje më efektive të pasurive që paraqesin interes kulturor. Gjithashtu, përmes përcaktimit të procedurave të unifikuara dhe rolit të secilit institucion përgjegjës, synohet shmangia e mbivendosjeve kompetenciale dhe përmirësimi i bashkërendimit institucional në procesin e deklarimit të pasurive kulturore.

Përparësitë kryesore të projektligjit konsistojnë në rritjen e sigurisë juridike, qartësimin e përgjegjësive institucionale, përmirësimin e efektivitetit të procedurave administrative dhe forcimin e mekanizmave të mbrojtjes dhe monitorimit të trashëgimisë kulturore. Nëpërmjet këtyre ndryshimeve pritet të

përmirësohet administrimi i pasurive kulturore, të forcohet koordinimi ndërinstitucional dhe të krijohen kushte më të favorshme për ruajtjen, promovimin dhe transmetimin e vlerave të trashëgimisë kulturore.

Efektet e pritshme të projektligjit lidhen me rritjen e efektivitetit të sistemit të mbrojtjes së trashëgimisë kulturore, përmirësimin e cilësisë së vendimmarrjes administrative, forcimin e kapaciteteve institucionale dhe harmonizimin e mëtejshëm të legjislacionit shqiptar me standardet dhe detyrimet ndërkombëtare në fushën e trashëgimisë kulturore.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË,KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj është hartuar në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Dispozitat e tij janë hartuar në harmoni me kuadrin ligjor vendas në fuqi, veçanërisht me ligjin nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", të ndryshuar, si dhe me legjislacionin që rregullon procedurat administrative, planifikimin dhe zhvillimin e territorit, mbrojtjen e mjedisit, administrimin e të dhënave shtetërore dhe menaxhimin e financave publike. Ndryshimet dhe shtesat e propozuara nuk krijojnë mbivendosje apo kundërshti me legjislacionin në fuqi, por forcojnë kuadrin normativ për mbrojtjen, administrimin dhe menaxhimin e trashëgimisë kulturore.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE

Ky projektligj ka për qëllim përafrimin e legjislacionit me *Acquis Communautaire.*

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 27/2018 ‘Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë’, të ndryshuar” synon përmirësimin dhe modernizimin e kuadrit ligjor në fushën e trashëgimisë kulturore, në funksion të forcimit të mbrojtjes, ruajtjes, administrimit dhe menaxhimit të qëndrueshëm të pasurive kulturore materiale dhe jomateriale. Nëpërmjet ndryshimeve të propozuara synohet adresimi i problematikave të evidentuara gjatë zbatimit të

ligjit në fuqi, qartësimi i kompetencave institucionale dhe harmonizimi i mëtejshëm i legjislacionit kombëtar me standardet dhe detyrimet ndërkombëtare në fushën e trashëgimisë kulturore.

Projektligji parashikon rishikimin dhe plotësimin e dispozitave që lidhen me përkufizimet dhe konceptet bazë të ligjit, procedurat e verifikimit dhe deklarimit të pasurive kulturore, administrimin dhe regjistrimin e tyre, si dhe rolin dhe kompetencat e institucioneve përgjegjëse në fushën e trashëgimisë kulturore. Gjithashtu, rregullohen në mënyrë më të detajuar procedurat që lidhen me mbrojtjen, ruajtjen, konservimin, restaurimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e pasurive kulturore.

Projektligji rishikon gjithashtu përkufizimin e muzeut, duke e harmonizuar atë me përkufizimin e miratuar nga Këshilli Ndërkombëtar i Muzeve (ICOM), sipas standardeve më të fundit ndërkombëtare në fushën e muzeologjisë.

Një nga risitë kryesore të projektligjit është krijimi i bazës ligjore për Vlerësimin e Ndikimit në Trashëgiminë Kulturore (VNT/HIA), si instrument teknik për identifikimin, analizimin dhe vlerësimin e ndikimeve që planet, programet, projektet dhe ndërhyrjet mund të kenë mbi pasuritë kulturore dhe vlerat e tyre të mbrojtura. Përfshirja e këtij instrumenti është realizuar në përputhje me rekomandimet dhe kërkesat e UNESCO-s për menaxhimin dhe mbrojtjen e pasurive të trashëgimisë kulturore, veçanërisht atyre me vlera të jashtëzakonshme universale, si dhe në përgjigje të rekomandimeve nga Kontrolli i Lartë i Shtetit lidhur me nevojën për krijimin e mekanizmave më efektivë për vlerësimin paraprak të ndikimeve që projektet dhe ndërhyrjet zhvillimore mund të kenë mbi pasuritë kulturore dhe zonat mbrojtëse të tyre.

Projektligji rregullon në mënyrë më të plotë ndërhyrjet në pasuritë kulturore të paluajtshme, duke përcaktuar procedura të veçanta për mirëmbajtjen, masat urgjente, ndërhyrjet ruajtëse, restaurimin, ndryshimin e destinacionit dhe përshtatjen funksionale të tyre. Në këtë kuadër, krijohen mekanizma që mundësojnë integrimin e pasurive kulturore në procese zhvillimi, duke garantuar ruajtjen e autenticitetit, integritetit dhe vlerave kulturore që ato mbartin.

Në fushën institucionale, projektligji qartëson kompetencat dhe përgjegjësitë e institucioneve të specializuara të trashëgimisë kulturore, forcon mekanizmat e bashkërendimit ndërinstitucional dhe rregullon më tej procedurat që lidhen me identifikimin, dokumentimin, regjistrimin dhe administrimin e pasurive kulturore, përfshirë administrimin e bazës shtetërore të të dhënave të trashëgimisë kulturore.

Projektligji krijon gjithashtu një kuadër më të plotë për mbështetjen financiare të

pasurive kulturore në pronësi jopublike, duke parashikuar mundësinë e mbështetjes përmes granteve, bashkëfinancimit dhe kontributeve në natyrë, në funksion të ruajtjes, konservimit dhe restaurimit të tyre. Krahas kësaj, përmirësohen dispozitat që lidhen me planifikimin, administrimin dhe përdorimin e fondeve dhe të ardhurave të dedikuara për trashëgiminë kulturore.

Një pjesë e rëndësishme e ndryshimeve lidhet me përafrimin e legjislacionit shqiptar me acquis të Bashkimit Evropian në fushën e importit, eksportit dhe rikthimit të pasurive kulturore. Për këtë qëllim, projektligji parashikon dispozita të reja për importin dhe eksportin e objekteve kulturore, licencat përkatëse, deklaratat e importuesit, procedurat për qarkullimin ndërkufitar të pasurive kulturore dhe mekanizmat për kthimin e pasurive kulturore të larguara ose të trafikuara në mënyrë të paligjshme.

Gjithashtu, projektligji përfshin dispozita të reja për vlerësimin financiar të pasurive kulturore, klasifikimin dhe regjistrimin e restauratorëve dhe mjeshtërve tradicionalë të restaurimit, si dhe përmirësimin e mekanizmave të administrimit dhe menaxhimit të muzeve dhe koleksioneve muzeore.

Në tërësi, projektligji synon të krijojë një kuadër ligjor më të plotë, më të qartë dhe më efektiv për mbrojtjen, ruajtjen, administrimin dhe promovimin e trashëgimisë kulturore, duke forcuar kapacitetet institucionale, sigurinë juridike dhe përputhshmërinë e legjislacionit kombëtar me standardet ndërkombëtare dhe evropiane në këtë fushë.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Ngarkohen për zbatimin e këtij ligji Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Mjedisit, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Agjencia e Zhvillimit të Territorit dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit.

VIII. MINISTRITË, INSTITUCIONET DHE SUBJEKTET E TJERA QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga Ministria e Turizmit, Kulturës, dhe Sportit dhe do të dërgohet për mendim nëpërmjet sistemit e-aktet pranë Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministrisë së Mjedisit, Agjencisë Shtetërore të Kadastrës si dhe në formë shkresore pranë Agjencisë së Zhvillimit të Territorit

dhe Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Projektligji parashikon efekte financiare për buxhetin e shtetit, të lidhura me zbatimin e skemave të mbështetjes financiare për pasuritë kulturore, administrimin e instrumenteve të reja të parashikuara në ligj dhe funksionimin e strukturave përgjegjëse për zbatimin e tij. Efektet financiare do të përballohen sipas planifikimeve buxhetore vjetore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë.

MINISTËR

Blendi Gonxhja